

VENDIM
Nr.872, datë 12.12.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.138, DATË 23.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET TEKNIKE TË VLERËSIMIT DHE PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PASURIVE, QË SHPRONËSOHEN, TË PASURIVE, QË ZHVLERËSOHEN DHE TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË TRETË, PËR INTERES PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Vlerësimi për truallin përcaktohet, sipas çmimeve të miratuara, me vendim të Këshillit të Ministrave, për trojet urbane, brenda vijës së verdhë, trojet në qytete dhe komuna, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar. Në rastet kur mungojnë çmimet e miratuara për zonat përkatëse, vlerësimi për truallin përcaktohet si mesatare e shitblerjeve, që ka zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP).”.

b) Paragrafi i parë, i pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Vlerësimi për tokën bujqësore, tokën pyjore, kullotat dhe livadhet përcaktohet sipas çmimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar. Në rastet kur mungojnë çmimet e miratuara për zonat përkatëse, vlerësimi për tokën bujqësore, tokën pyjore, kullotat dhe livadhet përcaktohet si mesatare e shitblerjeve, që ka zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP). Vlerësimi për bimët drufrutorë, pyjet dhe fidanishtet e përhershme përcaktohet si mesatare e shitblerjeve, që ka ZRPP-ja.”.

c) Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda 7 ditëve, duhet të vërë në dispozicion të subjekteve të interesuara çmimet e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, për zonat përkatëse, ku do të realizohet shpronësimi për interes publik.”.

2. Ky vendim nuk do të zbatohet në rastin e kërkesave për shpronësim, të cilat janë publikuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha